

Nr 15470 Aktit

V E N D I M

“ MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK ”

Sot me date 19.7. 1996 ne Tirane, une Gjyqtarja e Gjykates se Tiranes M. Deoli mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit ,Pirro gjinari , Adrian Strazimiri dhe Stojan Angjeli, per regjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregtare “SOFIGAZ” sh.p.k

K O N S T A T O V A

Kerkuesit kane paraqitur kerkese per te regjistruar si person juridik shoqerine tregtare “SOFIGAZ” sh.p.k . Kjo shoqeri ka seline e saj ne Tirane rruga “Sami Frasheri”prane Institutit te Hidraulikes, eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ka nje afat veprimtarie te pa kufizuar e mbi 10 vjet, ka nje kapital fillestar prej 100000 leke . Shoqeria ka zgjedhur si Administrator te Pergjithshem Z. Stojan Angjeli .Objekti i veprimtarise se saj eshte:

Prodhimi i produkteve kimike dhe aparatet perkatese, te gazit ne pergjithsi, ne vecanti per oksigjenin dhe tregtimin e tyre .Prodhimin dhe tregtimin e perzierjeve per logari te veten edhe per te tretet. Blerjen ne pergjithsi te mallrave dhe artikujve te industrise kimike, te paisjeve ndihmese dhe tregtimin e tyre. Zhvillimin dhe komercializimin e aktivitetit kerkimor dhe inxhinjrik me nje referim te vecante ne sektorin e gazrave teknike dhe aplikimet e tyre direkte. Perpunimin dhe drejtimin e informatikes se ndermarjes per llogari te te treteve. Blerjen dhe drejtimin e pjesmarrjeve industriale dhe komercilae. Ushtrimin e aktivitetit te lokacionit financiar (marrveshje midis paleve ku lihen peng pasurite e patundshme). Per kete qellim shoqeria mund te bleje, shese ndertoje dhe te kryeje instalime, montime dhe mirembajtje, dhe nepermjet te treteve te pasurise se tundshme dhe te patundshme, perfshire ketu automjetet, makinerite dhe impiantet te destinuar insiativave industriale, financiare dhe komerciale. Shoqeria mund te permbushe te gjitha operacionet komerciale, industriale dhe financiare, te tundshme dhe te patundshme te cilat sipas organit administrativ jane te dobishme dhe te nevojshme per realizimin e objektit.

Kerkesa eshte e bazuar dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992

## V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare "SOFIGAZ" sh.p.k me administrator z. Stojan Angjeli , me kapital fillestar 100000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet , me seli ne Tirane me objekt te veprimtarise ;

Prodhimi i produkteve kimike dhe aparatet perkatese, te gazit ne pergjithsi, ne vecanti per oksigjenin dhe tregtimin e tyre .Prodhimin dhe tregtimin e perzierjeve per logari te veten edhe per te tretet. Blerjen ne pergjithsi te malirave dhe artikujve te industrise kimike, te paisjeve ndihmese dhe tregtimin e tyre. Zhvillimin dhe komercializimin e aktivitetit kerkimor dhe inxhinjerik me nje referim te vecante ne sektorin e gazrave teknike dhe aplikimet e tyre direkte. Perpunimin dhe drejtimin e informatikes se ndermarjes per llogari te te treteve. Blerjen dhe drejtimin e pjesmarrjeve industriale dhe komercilae. Ushtrimin e aktivitetit te lokacionit financiar (marrveshje midis paleve ku lihen peng pasurite e patundshme). Per kete qellim shoqeria mund te bleje, shese ndertoje dhe te kryeje instalime, montime dhe mirembajtje, dhe nepermjet te treteve te pasurise se tundshme dhe te patundshme, perfshire ketu automjetet, makinerite dhe impiantet te destinuar insiativave industriale, financiare dhe komerciale. Shoqeria mund te permbushe te gjitha operacionet komerciale, industriale dhe financiare, te tundshme dhe te patundshme te cilat sipas organit administrativ jane te dobishme dhe te nevojshme per realizimin e objektit .Ortaket jane Pirro Gjinari, Adrian Strazimiri, Stojan Angjeli

Kunder Vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQTARE

*Maryana Dodi*  
*M. Dodi*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
"r. 15470/3 Vendimit

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 10.9.1996 une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane Marjana Dedi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Stojan Angjellari, Ardian Strazimiri, Pirro Gjnari ortak te shoqerise Tregtare "SOFIGAZ" dhe

K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr. 15470 date 19.7.1996 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria Tregtare "SOFIGAZ" SHPK ne gjykatën e rrethit Tirane.

Me kerkesen drejtuar gjykates kerkojme korigjimin mbiemrit te nje prej ortakëve te shoqerise nga Stojan Angjeli ne Stojan Angjellari.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7667 date 28.1.1993 dhe te ligjit 7638 date 19.11.1992

V E N D O S A

Franimin e kerkeses.

Depozitimin prane rregjistrimit Tregetar te kerkeses se shoqerise Tregtare "SOFIGAZ" SHPK per korigjimin e mbiemrit te ortakut nga Stojan Angjeli ne Stojan Angjellari.

Urdherohet zyra e rregjistrimit Tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen 5 .

GJYQTARE  
MARJANA DEDI



V E N D I M  
I Gjyqtarit te Vetem

Ne Tirane, sot me daten 4-12:1996, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., per depozitim e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 27.11.1996 te kesaj shoqerise

K O N S T A T O V A :

Se kerkuesi Stojan Angjellari, ka paraqitur kerkesen prane kesaj Gjykate per depozitim e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 27.11.1996 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane, Rruga Sami Frasheri, prane Instituti te Idrulikes dhe regjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr.15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i transferimit te kuotave te ortakeve shoqerise italiane Multigas Est srl si dhe lejohen ortaket te neneshkruajne kontraten perkatese ne te cilen Stojan Angjellari transferon 28 kuota ndersa Ardian Strazimiri dhe Pirro Gjinari nga 26 kuota sejcili.

Miratimi i ndryshimit te Statutit, neni 7, si me poshte: Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e meposhteme:

1. Multigas Est srl kontribon me shumen 80 mije lek.
2. Z. Stojan Angjellari kontribon me shumen 6 mije leke.
3. Z. Ardian Strazimiri kontribon me shumen 7 mije leke.
4. Z. Pirro Gjinari kontribon me shumen 7 mije leke.

Miratimi i ndryshimit te paragrafit te pare te nenit 8 te Statutit, si me poshte:

1. Shoqeria Multigas Est srl merr 80 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numri 1 deri ne numrin 80 te serise.
2. Z. Stojan Angjellari merr 6 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numri 81 deri ne numrin 86 te serise.
3. Z. Ardian Strazimiri merr 7 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numri 87 deri ne numrin 93 te serise.
4. Z. Pirro Gjinari merr 6 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numri 94 deri ne numrin 100 te serise.

Emerimi i Administratorit te shoqerise Sofigaz z. Maurizio Colombo, lindur me 19.08.1960, banues ne Milano, Via Ponte Vetro 1, nr. pashaporte 005244 N.

Miratimi i ndryshimit te paragrafit te dyte te nenit 9 te Statutit, si me poshte:

Pjeset e kapitalit themeltar mund tju transferohen te treteve me miratim te ortakut ose ortakeve qe perfaqesojne te pakten 75 % te kapitalit themeltar me kushte jo me te favoreshme se ato me te cilat u jane afruar me pare ortakeve te tjere.

Miratimi i nje paragrafi te ri qe shtohet ne fund te nenit 11 te Statutit, si me poshte:

Administratori mund te delegoje nje pjese ose te gjitha kompetencat e veta. Delegimi behet me shkrim.

Miratimi i zevendesimit te nenit 10 te Statutit si me poshte:

Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Ne te bejne pjese ortaket me te drejte vote, sipas numrit te kuotave te kontribuar ne kapitalin themelor. Ajo mund te mblidhet ne seline e shoqerise ose ne Itali.

Asambleja e Ortakeve vendos për bilanciin vjetor, për ndryshimet në statut, për shtimin dhe pakesimin e kapitalit themelor, për emerimin e Administratorit të Vetem, kompetencat e tij, emerimin e revisoreve, për pushimin e aktivitetit të shoqërisë etj.

Asambleja e Ortakeve i merr vendimet e saj me votën që përfaqëson shumicën e kapitalit themelor. Është e nevojshme votimi me 3/4 të kapitalit themeltar për çështjet e mëposhtme :

- për emerimin e administratorit të vetem, kompetencat e tij; ndryshimi i statutit; pakesimi dhe shtimi i kapitalit themelor; transferimi i kuotave të treta; zgjatja e aktivitetit të shoqërisë; pushimi i aktivitetit të shoqërisë; bilanci vjetor; aprovimi i programit vjetor të shoqërisë, veçanërisht përsa i përket investimeve.

Keto modalitete duhet të respektohen qoftë për mbledhjen e parë qoftë për të dytën.

Ngarkohet z. Stojan Angjellari të kryejë të gjitha veprimet ligjore për regjistrimin e këtij vendimi në organet kompetente.

Kërkesa e kerkuesit është e drejtë dhe në bazë të ligjit duhet pranuar.

### PER KETE ARSYE

Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare " dhe të ligjit 7667, datë 28.01.1993, "Për regjistrimin tregëtar dhe formalitetet që duhet të respektojnë shoqëritë tregëtare".

### V E N D O S A :

Miratimi i kërkesës për depozitimin e vendimit të Asamblesë së Ortakeve, datë 27.11.1996 të shoqërisë "Sofigaz" sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Sami Frashëri, pranë Institutit të Hidraulikës dhe regjistruar në Regjistrin Tregëtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me vendim nr.15470, datë 19.07.1996, në të cilin është vendosur:

Miratimi i transferimit të kuotave të ortakeve shoqërisë italiane Multigas Est srl si dhe lejohen ortaket të nënshkruajnë kontratën përkatëse në të cilën Stojan Angjellari transferon 28 kuota ndërsa Ardian Strazimiri dhe Pirro Gjinari nga 26 kuota sejeçili.

Miratimi i ndryshimit të Statutit, neni 7, si më poshtë: Kapitali themeltar përbehet nga kontributet e mëposhtme:

1. Multigas Est srl kontribon me shumën 80 mijë lek.
2. Z. Stojan Angjellari kontribon me shumën 6 mijë leke.
3. Z. Ardian Strazimiri kontribon me shumën 7 mijë leke.
4. Z. Pirro Gjinari kontribon me shumën 7 mijë leke.

Miratimi i ndryshimit të paragrafit të parë të nenit 8 të Statutit, si më poshtë:

1. Shoqëria Multigas Est srl merr 80 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri 1 deri në numrin 80 të serisë.
2. Z. Stojan Angjellari merr 6 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri 81 deri në numrin 86 të serisë.
3. Z. Ardian Strazimiri merr 7 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri 87 deri në numrin 93 të serisë.
4. Z. Pirro Gjinari merr 6 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri 94 deri në numrin 100 të serisë.

Emerimi i Administratorit të shoqërisë Sofigaz z. Maurizio Colombo, lindur me 19.08.1960, banues në Milano, Via Ponte Vetëro 1, nr. pashaportë 005244 N.

Miratimi i ndryshimit të paragrafit të dytë të nenit 9 të Statutit, si më poshtë:

Pjeset e kapitalit themeltar mund tju trasferohen te treteve me miratim te ortakut ose ortakeve qe perfaqesojne te pakten 75 % te kapitalit themeltar me kushte jo me te favoreshme se ato me te cilat u jane afruar me pare ortakeve te tjere.

Miratimi i nje paragrafi te ri qe shtohet ne fund te nenit 11 te Statutit, si me poshte:

Administratori mund te delegoje nje pjese ose te gjitha kompetencat e veta. Delegimi behet me shkrim.

Miratimi i zevendesimit te nenit 10 te Statutit si me poshte:

Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Ne te bejne pjese ortaket me te drejte vote, sipas numrit te kuotave te kontribuar ne kapitalin themelor. Ajo mund te mblidhet ne seline e shoqerise ose ne Itali.

Asamblea e Ortakeve vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin dhe pakesimin e kapitalit themelor, per emerimin e Administratorit te Vetem, kompetencat e tij, emerimin e revisoreve, per pushimin e aktivitetit te shoqerise etj.


Asamblea e Ortakeve i merr vendimet e saj me voten qe perfaqeson shumicen e kapitalit themelor. Eshte e nevojshme votimi me 3/4 te kapitalit themeltar per ceshtjet e meposhtme :

- per emerimin e administratorit te vetem, kompetencat e tij; ndryshimi i statutit; pakesimi dhe shtimi i kapitalit themelor; transferimi i kuotave te treteve; zgjatja e aktivitetit te shoqerise; pushimi i aktivitetit te shoqerise; bilanci vjetor; aprovimi i programit vjetor te shoqerise, veçanerisht persa i perket investimeve.

Keto modalitete duhet te respektohen qofte per mbledhjen e pare qofte per te dyten.

Ngarkohet z. Stojan Angjellari te kryeje te gjitha veprimet ligjore per regjistrimin e ketij vendimi ne organet kompetente.

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat e Regjistrimit nr. 4 dhe 5 me numer rendor 3. Te ndahen me vije te kuqe regjistrimet nga njeri tjetri.

Gjyqtare  
Mariana Dea  


V E N D I M  
I Gjyqtarit te Vetem

Ne Tirane, sot me daten 24.10......2001, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 29.09.2001 te kesaj shoqerie

K O N S T A T O V A :

Se kerkuesi Maurizio Colombo, Administrator, ka paraqitur kerkesen prane kesaj Gjykate per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 29.09.2001 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane, Rruga Sami Frasheri, prane Institutit te Idraulikes dhe regjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr. 15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i transferimit te te gjitha pjeseve te kapitalit qe i takojne ortakeve Stojan Angjeli dhe Pirro Gjinari tek ortakun Ardian Strazimiri. Ortaku Multigas Est srl heq dore nga e drejta e parablerjes qe i takon me rastin e transferimit te ketyre pjeseve. Lejohen ortakët e interesuar te neneshkruajne kontraten perkatese te transferimit; a) Miratimi i ndryshimit te Statutit, neni 7, si me poshte:

- Multigas Est srl kontribon me shumen 80 mije leke.

- Z. A. Strazimiri kontribon me shumen 20 mije leke;

b) Miratimi i ndryshimit te Statutit, neni 8, paragrafi i pare, si me poshte:

- Shoqeria Multigas Est srl mer 80 pjese te kapitalit themeltar.

- Z. Ardian Strazimiri mer 20 pjese te kapitalit themeltar;

Ngarkohet Administratori i Shoqerise, z. Maurizio Colombo te kryeje te gjitha veprimet ligjore per regjistrimin e ketij vendimi ne organet kompetente.

Kerkesa e kerkuesit eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

P E R K E T E A R S Y E

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare " dhe te ligjit 7667, date 28.01.1993, "Per regjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhet te respektojne shoqerite tregetare".

V E N D O S A :

Miratimin e kerkeses per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 29.09.2001 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane, Rruga Sami Frasheri, prane Institutit te Idraulikes dhe regjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr. 15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i transferimit të të gjitha pjesëve të kapitalit që i takojnë ortakëve Stojan Angjeli dhe Pirro Gjinari tek ortakë Ardian Strazimiri. Ortaku Multigas Est srl heq dorë nga e drejta e parablerjes që i takon me rastin e transferimit të këtyre pjesëve. Lejohen ortakët e interesuar të nënshkruajnë kontratën përkatëse të transferimit; a) Miratimi i ndryshimit të Statutit, neni 7, si më poshtë:

- Multigas Est srl kontribon me shumën 80 mijë lekë.

- Z. A. Strazimiri kontribon me shumën 20 mijë lekë;

b) Miratimi i ndryshimit të Statutit, neni 8, paragrafi i parë, si më poshtë:

- Shoqëria Multigas Est srl mer 80 pjesë të kapitalit themeltar.

- Z. Ardian Strazimiri mer 20 pjesë të kapitalit themeltar;

Ngarkohet Administratori i Shoqërisë, z. Maurizio Colombo të kryejë të gjitha veprimet ligjore për regjistrimin e këtij vendimi në organet kompetente.

Të behen ndryshimet përkatëse në kollonat e Regjistrimit nr. 4 dhe 5 me numër rendor 3.

Të ndahen me vije të kuqe regjistrimet nga njëri tjetri.

Gjyqtare  
*Mirita Cop*  
*1000*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
NR. 15470/4 AKTI

V E N D I M  
I G j y q t a r i t t e V e t e m

Ne Tirane, sot me daten 24.10......2001, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 30.09.2001 te kesaj shoqerie

K O N S T A T O V A :

Se kerkuesi Maurizio Colombo, Administrator, ka paraqitur kerkesen prane kesaj Gjykate per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 30.09.2001 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane, Rruga Sami Frasheri, prane Institutit te Idraulikes dhe rregjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr. 15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i bilancit te vitit 2000 te shoqerise dhe raporti perkates; Miratimi i shtimit te kapitalit nga 100.000 leke ne 20.200.000 leke. Ky shtim kapitali kryhet nga ortaku shoqeria Multigas Est srl dhe perfaqeson shtimin ne para te 300.000.000 Lira Italiane, me kursin e fiksuar prej 0.067 leke/lira, behet 20.100.000 leke dhe ne pjese me nga 1.000 leke sejcila behet 20.100 pjese te kapitalit themeltar; a) Miratimi i ndryshimit te Statutit, neni 7, si me poshte:

Kapitali themeltar perbehet nga 20.200.000 leke e ndare midis ortakeve si me poshte :

- Multigas Est srl kontribon me shumen 20.180.000 leke.
- Z. A. Strazimiri kontribon me shumen 20.000 leke;

b) Miratimin e ndryshimit te Statutit, neni 8, paragrafi i pare, si me poshte:

- Shoqeria Multigas Est srl mer 20.180 pjese te kapitalit themeltar ose 99.9 % e tij.
- Z. Ardian Strazimiri mer 20 pjese te kapitalit themeltar ose me 0.1 % e tij;

Asambleja vendosi qe 10 % te fitimit neto te shoqerise ti akordohet ortakut A. Strazimiri i cili do ta perdore per blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vlere nominale, deri sa te plotesoje, brenda 4 vjeteve, jo me shume se 10 % te krejt kapitalit themeltar;

Ngarkohet Administratori i Shoqerise, z. Maurizio Colombo te kryeje te gjitha veprimet ligjore per regjistrimin e ketij vendimi ne organet kompetente.

Kerkesa e kerkuesit eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

P E R K E T E A R S Y E

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare " dhe te ligjit 7667, date 28.01.1993, "Per rregjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhet te respektojne shoqerite tregetare".

V E N D O S A :

Miratimin e kerkeses per depozitim e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 30.09.2001 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane, Rruga Sami Frasheri, prane Institutit te Idraulikes dhe rregjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr. 15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i bilancit te vitit 2000 te shoqerise dhe raporti perkates; Miratimi i shtimit te kapitalit nga 100.000 leke ne 20.200.000 leke. Ky shtim kapitali kryhet nga ortakut shoqeria Multigas Est srl dhe perfaqeson shtimin ne para te 300.000.000 Lira Italiane, me kursin e fiksuar prej 0.067 leke/lira, behet 20.100.000 leke dhe ne pjese me nga 1.000 leke sejcila behet 20.100 pjese te kapitalit themeltar; a) Miratimi i ndryshimit te Statutit, neni 7, si me poshte:

Kapitali themeltar perbehet nga 20.200.000 leke e ndare midis ortakeve si me poshte :

- Multigas Est srl kontribon me shumen 20.180.000 leke.
- Z. A. Strazimiri kontribon me shumen 20.000 leke;


b) Miratimin e ndryshimit te Statutit, neni 8, paragrafi i pare, si me poshte:

- Shoqeria Multigas Est srl mer 20.180 pjese te kapitalit themeltar ose 99.9 % e tij.
- Z. Ardian Strazimiri mer 20 pjese te kapitalit themeltar ose me 0.1 % e tij;

Asambleja vendosi qe 10 % te fitimit neto te shoqerise ti akordohet ortakut A. Strazimiri i cili do ta perdore per blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vlere nominale, deri sa te plotesoje, brenda 4 vjeteve, jo me shume se 10 % te krejt kapitalit themeltar;

Ngarkohet Administratori i Shoqerise, z. Maurizio Colombo te kryeje te gjitha veprimet ligjore per regjistrimin e ketij vendimi ne organet kompetente.

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat e Regjistrit nr. 4 dhe 5 me numer rendor 3. Te ndahen me vije te kuqe regjistrimet nga njeri tjetri.

Gjyqtare  
  
Maurizio Colombo  
19/07/2000

V E N D I M  
I G j y q t a r i t t e V e t e m

Ne Tirane, sot me daten 08.07.....2003, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., per depozitimimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 08.07.2003 te kesaj shoqerie

K O N S T A T O V A :

Se kerkuesi Maurizio Colombo, Administrator, ka paraqitur kerkesen prane kesaj Gjykate per depozitimimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 08.07.2003 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane dhe rregjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr. 15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i transferimit te pjeseve te kapitalit nga ortaku Multigas Est Srl tek ortaku A. Strazimiri. Z. Ardian Strazimiri, behet ortak me 735,332 pjese kapitali ose 735.332 Leke ose 3,64 % te kapitalit; Miratimi i ndryshimit te Statutit, neni 7, si me poshte :

Kapitali themeltar perbehet nga 20.200.000 leke e ndare midis ortakeve si me poshte :

- Multigas Est Srl kontribon me shumen 19.464.668 leke.
- Z. A. Strazimiri kontribon me 735.332 leke;

Miratimi i ndryshimit te Statutit, neni 8, si me poshte :

- Shoqeria Multigas Est Srl mer 19.464,668 pjese te kapitalit themeltar ose 96,36 %
- Z. Ardian Strazimiri mer 735,332 pjese te kapitalit themeltar ose 3,64 %:

Rikonfirmimi i riemerimit ne detyre edhe per pese vjete te tjera i administratorit, z. Maurizio Colombo; Ngarkohet Administratori i Shoqerise, z. Maurizio Colombo te kryeje te gjitha veprimet ligjore per regjistrimin e ketij vendimi ne organet kompetente.

Kerkesa e kerkuesit eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

P E R K E T E A R S Y E

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare " dhe te ligjit 7667, date 28.01.1993, "Per rregjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhet te respektojne shoqerite tregetare".

V E N D O S A :

Miratimin e kerkeses per depozitimimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 08.07.2003 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane dhe rregjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr. 15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i transferimit të pjesëve të kapitalit nga ortakët Multigas Est Srl tek ortakët A. Strazimiri. Z. Ardian Strazimiri, behet ortak me 735,332 pjesë kapitali ose 735.332 Leke ose 3,64 % të kapitalit; Miratimi i ndryshimit të Statutit, neni 7, si më poshtë :

Kapitali themeltar përbehet nga 20.200.000 leke e ndare midis ortakëve si më poshtë :

- Multigas Est Srl kontribon me shumën 19.464.668 leke.
- Z. A. Strazimiri kontribon me 735.332 leke;

Miratimi i ndryshimit të Statutit, neni 8, si më poshtë :

- Shoqëria Multigas Est Srl mer 19.464,668 pjesë të kapitalit themeltar ose 96,36 %
- Z. Ardian Strazimiri mer 735,332 pjesë të kapitalit themeltar ose 3,64 %;

Rikonfirmimi i riemërimit në detyrë edhe për pesë vjetë të tjera të administratorit, z. Maurizio Colombo; Ngarkohet Administratori i Shoqërisë, z. Maurizio Colombo të kryejë të gjitha veprimet ligjore për regjistrimin e këtij vendimi në organet kompetente.

Të behen ndryshimet përkatëse në kollonat e Regjistrimit nr. 4 dhe 5 me numër rendor 3.  
Të ndahen me vije të kuqe regjistrimet nga njeri tjetri.

Gjyqtare  
*Carulla Capo*  
*M. F. no.*

V E N D I M  
I Gjyqtarit te Vetem

Ne Tirane, sot me daten 09.07.....2004, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 29.06.2004, te kesaj shoqerie

K O N S T A T O V A :

Se kerkuesi Maurizio Colombo, Administrator, ka paraqitur kerkesen prane kesaj Gjykate per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 29.06.2004 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane dhe rregjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr. 15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i bilancit te vitit 2003; Miratimin e transferimit te pjeseve te kapitalit nga ortaku Multigas Est Srl tek ortaku A. Strazimiri. Z. Ardian Strazimiri, behet ortak me 2.020,000 pjese kapitali ose 2.020.000 Leke ose 10 % te kapitalit. Ardian Strazimiri eshte i detyruar qe per nje periudhe prej tre vjetesh nga fitimi i pronesise se pjeseve te kapitalit te mos jau shese ato te treteve; a)Miratimin e ndryshimit te Statutit, neni 7, si me poshte :

Kapitali themeltar perbehet nga 20.200.000 leke e ndare midis ortakeve si me poshte :

- Multigas Est Srl kontribon me shumen 18.180.000 leke.
- Z. A. Strazimiri kontribon me 2.020.000 leke.

b)Miratimin e ndryshimit te Statutit, neni 8, si me poshte :

- Shoqeria Multigas Est Srl mer 18.180.000 pjese te kapitalit themeltar ose 90 %
- Z. Ardian Strazimiri mer 2.020.000 pjese te kapitalit themeltar ose 10 %;

Miratohet shtimi i objektit te veprimtarise si me poshte :

"Prodhimin, shperndarjen dhe tregetimin e gazeve mjekesore, qe bejne pjese ne Farmacopea-n Zyrtare, speciale dhe te aparaturave dhe materialeve perkates per perdorimin e tyre, duke perfshire aktivitetin dhe sherbimet e lidhura me kriobiologjine dhe bio – mjekesine (perdorimet e biokimise ne mjekesi); Organizimin, drejtimin dhe kontrollin e sherbimeve, asistences dhe kujdesit ne kushtet e shtepise ne çdo lloj forme te tyre, duke ju referuar veçanerisht terapise me oksigjen dhe ventiloterapise, duke perfshire ketu tregetimin e aparaturave dhe materialeve qe kane te bejne me perdorimin e tyre; Transportin e te gjitha produkteve te siperpermendura, gaze dhe impiante, per llogari te veten dhe te treteve; Blerjen dhe drejtimin e pjesmarjeve industriale dhe tregetare ne shoqeri apo ndermarje, te krijuara ose ne krijim, te cilat kane objekt analog, te ngjashem, ose sidoqofte qe lidhet me objektin e vet, me kusht qe kjo te mos perbeje aktivitetin mbizoterues ose kryesor te shoqerise.";

Meqenese i gjithe aktiviteti i shoqerise eshte transferuar ne seline e re atehere selia e shoqerise ndryshon nga Rruga Sami Frasheri ne : "Autostraden Tirane – Dures, Km. 4,5, Tirane.";

Ngarkohet Administratori i Shoqerise, z. Maurizio Colombo te kryeje te gjitha veprimet ligjore per regjistrimin e ketij vendimi ne organet kompetente.

Kerkesa e kerkuesit eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

### PER KETE ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare " dhe te ligjit 7667, date 28.01.1993, "Per rregjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhet te respektojne shoqerite tregetare".

### V E N D O S A :

Miratimin e kerkeses per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve, date 08.07.2003 te shoqerise "Sofigaz" sh.p.k., me seli ne Tirane dhe rregjistruar ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me vendim nr. 15470, date 19.07.1996, ne te cilin eshte vendosur:

Miratimi i bilancit te vitit 2003; Miratimin e transferimit te pjeseve te kapitalit nga ortaku Multigas Est Srl tek ortaku A. Strazimiri. Z. Ardian Strazimiri, behet ortak me 2.020,000 pjese kapitali ose 2.020.000 Leke ose 10 % te kapitalit. Ardian Strazimiri eshte i detyruar qe per nje periudhe prej tre vjetesh nga fitimi i pronesise se pjeseve te kapitalit te mos jau shese ato te treteve; a)Miratimin e ndryshimit te Statutit, neni 7, si me poshte :

Kapitali themeltar perbehet nga 20.200.000 leke e ndare midis ortakeve si me poshte :

- Multigas Est Srl kontribon me shumen 18.180.000 leke.
- Z. A. Strazimiri kontribon me 2.020.000 leke.

b)Miratimin e ndryshimit te Statutit, neni 8, si me poshte :

- Shoqeria Multigas Est Srl mer 18.180.000 pjese te kapitalit themeltar ose 90 %
- Z. Ardian Strazimiri mer 2.020.000 pjese te kapitalit themeltar ose 10 %;

Miratohet shtimi i objektit te veprimtarise si me poshte :


"Prodhimin, shperndarjen dhe tregetimin e gazeve mjekesore, qe bejne pjese ne Farmacopea-n Zyrtare, speciale dhe te aparaturave dhe materialeve perkates per perdorimin e tyre, duke perfshire aktivitetin dhe sherbimet e lidhura me kriobiologjine dhe bio - mjekesine (perdorimet e biokimise ne mjekesi); Organizimin, drejtimin dhe kontrollin e sherbimeve, asistences dhe kujdesit ne kushtet e shtepise ne çdo lloj forme te tyre, duke ju referuar veçanerisht terapise me oksigjen dhe ventiloterapise, duke perfshire ketu tregetimin e aparaturave dhe materialeve qe kane te bejne me perdorimin e tyre; Transportin e te gjitha produkteve te siperpermendura, gaze dhe impiante, per llogari te veten dhe te treteve; Blerjen dhe drejtimin e pjesmarjeve industriale dhe tregetare ne shoqeri apo ndermarje, te krijuara ose ne krijim, te cilat kane objekt analog, te ngjashem, ose sidoqofte qe lidhet me objektin e vet, me kusht qe kjo te mos perbeje aktivitetin mbizoterues ose kryesor te shoqerise.";

Meqenese i gjiithe aktiviteti i shoqerise eshte transferuar ne seline e re atehere selia e shoqerise ndryshon nga Rruga Sami Frasheri ne : "Autostraden Tirane - Durres, Km. 4,5, Tirane.";

Ngarkohet Administratori i Shoqerise, z. Maurizio Colombo te kryeje te gjitha veprimet ligjore per rregjistrimin e ketij vendimi ne organet kompetente.

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat e Regjistrit nr. 4 dhe 5 me numer rendor 3. Te ndahen me vije te kuqe regjistrimet nga njeri tjetri.

G j y q t a r e

Ardian Strazimiri  


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
NR 15470 / 7 VENDIMI

**V E N D I M**  
**I**  
**GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane sot me daten 14/7/ 2005 (dymije e pese), une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane 6, 71, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Maurizio COLOMBO, me cilesine e Administratorit te shoqerise "SOFIGAZ" shpk Tirane, per depozitimin prane Regjistrat Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane te Vendimit nr 7 date 20.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "SOFIGAZ" SHPK.

***K o n s t a t o v a :***

Se kerkuesi Maurizio COLOMBO, me cilesine e administratorit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SOFIGAZ" shpk, ka paraqitur para gjykates se Shkalles se pare Tirane Kerkesen per depozitimin prane Zyres se Rregjistrat tregtar te dokumentave te kesaj shoqerie e themeluar si e tille me Vendim Gjykate nr 15470 date 19.07.1996.

Asambleja e Ortakeve te kesaj shoqerie ne Vendimin nr 7 date 20.05.2005 ka vendosur:

1. Te Zmadhoj Kapitalin themeltar te shoqerise, me kontribut ne natyre sipas bilancit.
2. Te kerkoje caktimin e nje Ekspert Kontabel te Autorizuar per Zmadhimin e Kapitalit themeltar, per te ndjekur procedurat e ketij zmadhimi.
3. Te kerkoj depozitimin e ketij vendimi, prane Rregjistrat Tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare, Tirane.

Sa me siper cmoj se dokumentacioni eshte i plote, kerkesa eshte e drejt dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

## **PER KETO ARSYE :**

Ne baze te Ligjit Nr 7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe Ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare",

## **VENDOSA :**

Pranimin e kerkeses:

1. Depozitim prane Regjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane te Kerkeses se Administratorit Maurizio COLOMBO, ne emer te shoqerise "SOFIGAZ" shpk dhe Vendimin nr 7 date 20.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise, mbi Zmadhimin e kapitalit themeltar.
2. Caktimin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, Vjollca DERVISHI , per te ndjekur procedurat e Zmadhimit te Kapitalit themeltar te shoqerise.
3. Urdherimin e Zyres se Regjistrin tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne regjistrin tregtar.
4. Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

**GJYQTAR**

*Arbërie P/10*

*[Signature]*



**V E N D I M**  
**I**  
**GJYQATARIT TE VETEM**

Ne Tirane sot me daten 18/7/2005 (dymije e pese), une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane Elza, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Maurizio COLOMBO, me cilesine e Administratorit te shoqerise "SOFIGAZ" shpk Tirane, per depozitimin prane Regjistrat Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane te Vendimit nr 8 date 15.07.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "SOFIGAZ" shpk, dhe te Akt Ekspertimit te Zmadhimit te Kapitalit themeltar te kesaj shoqerie,

***Konstatova:***

Se kerkuesi Maurizio COLOMBO me cilesine e administratorit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SOFIGAZ" shpk, ka paraqitur para gjykates se Shkalles se pare Tirane Kerkesen per depozitimin prane Zyres se Rregjistrat tregtar te dokumentave te kesaj shoqerie e themeluar si e tille me Vendim Gjykate nr 15470 date 19.07.1996.

Me Vendim gjykate nr 15470/7 date 14.07.2005 eshte caktuar eksperti kontabel i Autorizuar per te realizuar zmadhimin e kapitalit te shoqerise me kontribut ne natyre, sipas bilancit.

Asambleja e Ortakeve te kesaj shoqerie me Vendimin nr 8 date 15.07.2005 ka vendosur:

1. Te Miratoje Akt Ekspertimin e realizuar nga Ekspert Kontabel i Autorizuar, Vjollca DERVISHI, mbi Zmadhimin e Kapitalit themeltar te shoqerise, me kontribut ne natyre sipas bilancit.
2. Zmadhimin e Kapitalit themeltar, me perfshirje te rezervave e fitimeve, prej 29.800.000 leke, duke e cuar Kapitalin ne kuoten e 50.000.000 leke, me pjesmarrje ne masen 90 % per Shoqerine "Multigas Est" srl dhe 10% per Ardian Strazimiri.
3. Te kerkoj depozitimin e ketij vendimi dhe te Akt Ekspertimit te zmadhimit te kapitalit, prane Rregjistrat Tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare, Tirane.

Sa me sipër cmoj se dokumentacioni është i plotë, kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

**PER KETO ARSYE :**

Në bazë të Ligjit Nr 7667 datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar" dhe Ligjit Nr 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare",



**V E N D O S A :**

Pranimin e kërkesës:

1. Depozitim prane Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë të Kërkesës së Administratorit Maurizio COLOMBO, në emër të shoqërisë "SOFIGAZ" shpk, Vendimit nr 8 datë 15.07.2005 i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, mbi Miratimin e Akt Ekspertimit për Zmadhimin e Kapitalit themeltar, si dhe Akt Ekspertimit të realizuar për këtë qëllim nga EKA: Vjollca DERVISHI.
2. Të Zmadhojë Kapitalin themeltar të shoqërisë me 29.800.000 leke, duke e çuar nga kuota e 20.200.000 leke në 50.000.000 leke, me pjesëmarrje 90 % për Shoqërinë "Multigas Est" srl dhe 10% për Ardian Strazimiri.
3. Urdhërimin e Zyres së Regjistrin tregtar të Gjykatës së shkallës së Parë Tiranë të bëjë ndryshimet në regjistrin tregtar.
4. Të ndahen regjistrimet nga njëri tjetri me vije të kuqe.

Kunder këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

**G J Y Q T A R**

  
\_\_\_\_\_  


Utrouletti neqni strumi

15470

2 a. "Sofigati, shi pu."

b. Ri. "Dami, Frashiu, grave institut te Hidraulikut. "Erdue"

c. Breglim, transport, produllim, produllitve te # te pozit, "Elektrifiku", autimuj kozmetiku,

e. 100 000 velle:

Stojan. Angeli	34.
Stojan. Serajmiri	33.
Petro Gjigari	33.

3. Adm. i retive: Stojan. Angeli 9/11/57  
banus. Ri. M. Gjullari, d. 5  
p. 43/27/163 "Erdue"

4- koyer  
M. - 3 flete  
K. - 6 flete + 1 M.

16-7-96  
19-7-96

*[Signature]*

MA: 06744 Nr. regj 17-0813-7221-01

Ju L. Erdue

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"SOFIGAZ" SH.P.K**

Personat qe firmosin me poshte :

1. **Stojan Angjeli** i biri i Margaritit lindur me 13.12.1957 ne Tirane dhe banues ne Tirane Rruga "Muhamet Gjolllesha" lagjia nr 5 pallati 43/27/163 me leternjoftim nr 0532927
2. **Ardian Strazimiri** i biri i Rushitit lindur me 01.06.1957 nr Tirane dhe banues ne Tirane Rruga "Ali Demi" pallati 135 shkalla 6 apartamenti 64 me leternjftimin UG 016779
3. **Pirro Gjinari** i biri i Jorgjit lindur me 12.12.1957 ne Tirane dhe banues ne Tirane Rruga "Margarita Tutulani" pallati 13/1 apartamenti 1 me nr leternjoftimi 10/74

Kane hartuar si me poshte kontraten e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te cilen jane marre vesh ta themelojne ndermjet tyre.

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht por jo ekskluzivisht, me nenet 11 dhe 12 " Per Dispozitat Kryesore Kushtetuese" Ligjin nr 7594 date 04.08.1992 " Per investimet e huaja" ligjin nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare ligjin 7667 date 28.01.1993 " per regjistrimin tregtar si dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise , si dhe dispozitat e statutit te shoqerise qe i bashkangjitet aktit themelues.

**Emri i shoqerise** eshte "SOFIGAZ" sh.p.k

**Selia e shoqerise** ndodhet ne Tirane ne adresen : Rruga "Sami Frasherit" prane Institutit te Idraulikes, nr.tel 274 18.

**Objekti i veprimtarise** se shoqerise do te jete :

- prodhimi i produkteve kimike dhe aparatet perkatese, te gazit ne pergjithesi dhe ne vecanti per oksigjienin, tregtimin e tyre ;
- prodhimin dhe tregtimin e perzjerjeve per llogari te veten por edhe per te tretet .
- blerjen ne pergjithesi te mallrave dhe artikujve te industrise kimike, te pajisjeve ndihmese dhe tregtimin e tyre.
- zhvillimin dhe komercializimin e aktivitetit kerkimor dhe inxhinierik me nje referim te vecante ne sektorin e gazrave teknike dhe aplikimet e tyre direkte
- perpunimin dhe drejtimin e informatikes se ndermarrjes per llogari te te treteve
- blerjen dhe drejtimin e pjesemarrjeve industriale dhe komerciale
- ushtrimin e aktivitetit te lokacionit financiar ( marreveshje midis paleve ku lihen peng pasurite e patundshme).

Per këte qellim shoqeria mund te bleje, shese, ndertoje dhe te kryeje instalime, montime dhe mirembajtje, dhe nepermjet te treteve, te pasurise se tundshme dhe te patundshme, perfshire ketu automjetet, makinerite dhe impiantet te destinuar inisiativave industriale, financiare dhe komerciale. Shoqeria mund te permbushe te gjitha operacionet komerciale, industriale dhe financiare te patundshme dhe te patundshme te cilat sipas organit Administrativ jane te dobishme e te nevojshme per realizimin e objektit social.

Import eksport e te gjitha artikujve te cdo lloji e tipi.

**Kapitali Themeltar** i shoqerise eshte 100000 leke. Ky kapital perbehet nga kontributet e meposhtme:

1. Stojan Angjeli kontribon me shumen 34 mije leke
2. Adrian Strazimiri kontribon me shumen 33 mije leke
3. Pirro Gjinari kontribon me shumen 33 mije leke

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese, plotesisht te shlyera me vlere 1000 leke sejcila, te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100

Ne baze te kontributeve te lartepemendura :

1. Z. Stojan Angjeli merr 34 pjese te kapitalit themeltar te renditura nga numri 1 deri ne 34 te serise.
2. Z. Adrian Strazimiri merr 33 pjese te kapitalit themeltar te renditura nga numri 35 deri ne 67 te serise

Te gjithe pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar plotesisht dhe jane shperndare nepermjet oratakeve si me poshte;

Sejcili prej ortakeve te ardhshem ka derdhur tek zoti Pirro Gjinari shumen koresponduese te pjeseve te nenshkruara.

Shumat e mbledhura jane depozituar prej tij ne Banken e Shqiperise ne nje llogari te hapur ne emer te shoqerise ne formim e siper.


Shuma e depozituar vertetohet me ane te nje certifikate te leshuar nga kjo Banke, ne te cilen shenohen emrat dhe mbiemrat e ortakeve te ardhshem, pjeset e kapitalit themeltar te nenshkruara dhe shuma e derdhur nga sejcili prej tyre.

Personat qe firmosin kete kontrate, pasi kane marre dijene per kete certifikate, nje kopje ekzakte e te ciles ju eshte paraqitur atyre, deklarojne se shumet e derdhura prej tyre jane ne perputhje me ate qe shenohet ne certifikate dhe se ata konfirmojne nenshkrimet e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumet respektive te derdhura.

Shoqeria **do te administrohet** nga nje administrator i vetem. Administratori i pare i emeruar eshte Zoti Stojan Angjeli me nje mandat 5 vjecar dhe me te drejte rizgjedhjeje.

Zotit Stojan Angjeli i jepen te gjitha kopetencat, te cilat ai i pranon, per te kryer te gjitha formalitetet e themelimit te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Ai gjithashtu eshte i autorizuar te veproje ne emer te shoqerise qe krijohet deri ne regjistrimin e saj ne gjykate, vecanerisht ai eshte i paisur me mandat per te kryer akte dhe per te marre angazhime ne emer te shoqerise, te cilat i kalojne shoqerise qe nga momenti i regjistrimit.



Pervec te tjerave administratori eshte i ngarkuar per te kryer akte dhe angazhime qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise dhe kopetencat e tij.

Pasi te behet miratimi i shoqerise , keto akte dhe angazhime i nenshtrohen miratimit te bashkesise se ortakeve, jo me vone se nga data e mbledhjes se Asamblese qe shqyrton dhe vendos mbi llogarite e vitit te pare financiar.


Ky miratim ben automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te shoqerise.

Kjo kontrate themeluese eshte hartuar ne Tirane me 15.07.1996 ne pese ekzemplare origjinal

1. z.Stojan Angjeli



2. z.Adrian Strazimiri



3. z.Pirro Gjinari



# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “ SOFIGAZ “ SH.P.K

1. **Stojan Angjeli** i biri i Margaritit lindur me 13.12.1957 banues ne Tirane Rruga “Muhamet Gjollasha” lagjia nr 5 pallati 43/27/163 nr leternjoftimit 0532927
2. **Pirro Gjinari** i biri i Jorgjit lindur me 12. 12. 1957 banues ne Tirane Rruga “Margarita Tutulani “ pallati 13/1 apartamenti 1 nr leternjoftimit 10/74
3. **Ardian Strazimiri** i biri i Reshitit lindur me 1.6.1957 banues ne Tirane Rruga “Ali Demi” pallati 135 shkalla 6 apartamenti 64 nr i leternjoftimit UG 016779

Kane hartuar statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te cilen jane marre vesh ta themelojne ndermjet tyre .

#### KREU I

#### FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

##### Neni 1

##### Forma

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht, por jo ekskluzivisht me nenet 11 dhe 12 te ligjit nr 7491 date 29.04.1991 “ Per Dispozitat Kryesore Kushtetuese” ligjin nr 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite Tregtare” Ligjin 7667 date 28.01.1993 “Per regjistrimin tregtar” aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe dispozitat e statutit te shoqerise dhe Aktit themelues

##### Neni 2

##### Emertimi i Shoqerise

Emri i shoqerise eshte “SOFIGAZ “ sh.p.k

##### Neni 3

##### Objekti i Shoqerise

Objekti i shoqerise eshte zhvillimi i veprimtarise afariste ne fushat :

-Prodhimin e produkteve kimike dhe aparatet perkatese, te gazit ne pergjithesi , ne vecanti per oksigjenin, dhe tregtimin e tyre.



-Prodhimin dhe tregtimin e perzierjeve per llogari te veten por edhe per te tretet.

-Blerjen ne pergjithesi te mallrave dhe artikujve te industrise kimike, te paisjeve ndihmese, dhe tregtimin e tyre.

-Zhvillimin dhe komercializimin e aktivitetit kerkimor dhe inxhinierik me nje referim te vecante ne sektorin e gazrave teknike dhe aplikimet e tyre direkte

-punimin dhe drejtimin e informatikes se ndermarjes per llogari te te treteve

-Blerjen dhe drejtimin e pjesmarrjeve industriale dhe komerciale

-Ushtrimin e aktivitetit te lokacionit financiar (marrveshje midis paleve ku lihen peng pasurite e patundshme).

Per kete qellim shoqeria mund te bleje , shese, te ndertoje dhe te kryeje instalime, montime dhe mirembajtje, dhe nepermjet te treteve te pasurise se tundshme dhe te patundshme, perfshi ketu automjetet, makinerite dhe impiantet te destinuar iniciativave industriale, financiare dhe komerciale. Shoqeria mund te permbushe te gjitha operacionet komerciale, industriale dhe financiare, te tundshme dhe te patundshme te cilat sipas Organit Administrativ jane te dobishme e te nevojshme per realizimin e objektit sociale.

Import eksportin e te gjitha artikujve te cdo lloji e tipi.

**Neni 4**

### **Selia e Shoqerise**

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen Rruga "Sami Frasheri" prane Institutit te Idraulikes. Transferimi i shoqerise ne nje adrese tjeter behet me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 pjese te kapitalit themeltar.

**Neni 5**

### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe mbi 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne gjykate .

Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ,ose te shkurtohet kur shoqeria priset parakohe.

